

# RAPORT

# VLERESIMI

**PRONA: Pas. Nr. 146/17- N NDERTESE 450m<sup>2</sup>  
“ZYRA + MAGAZINE”**

---

- Vleresim i Objektit Ndertimore 450m<sup>2</sup>
  - Vleresim i makinerive dhe pajisjeve
  - Vleresim Automjete
- 

**ADRESA:           Aeroporti Rinas, Tirane**

**POROSITESI:   Gjykata e Rrethit Gjyqesore Tirane**

Sipas Kerkeses te ADMINISTRATORIT te FALIMENTIT te  
Shoqerise “Albanian Airlines” shpk

**VLERESUESI:**   Ing. Gjergji Kotori  
Lic. Nr. 0106/1, shkalla e Pare

# PERMBAJTJA

## PËRMBLEDHJE EKZEKUTIVE

### PERMBAJTJA

#### I. INSTRUKSIONE

1. DATA E VLERESIMIT
2. POROSITESI
3. ADRESA, PRONARI
4. BAZA E VLERESIMIT
5. DOKUMENTAT NE KONSIDERATE
6. VENDNDODHJA E PRONES
7. PERSHKRIMI I PRONES
8. SIPERFAQET
9. URBANISTIKA SHERBIMET
10. PRONESIA
11. KUSHTET Taksat
12. VLERESIMI
13. REZERVIME DHE SUPOZIME

#### LIDHJET SHITESE

- FOTO TE PRONES
- HARTA E VENDODHJES
  - PLANVENDOSJA
  - PLANIMETRIA E NDERTESSES
- DOKUMENTET LIGJORE

## I. INSTRUKSIONE

### Te nderuar Zonja / Zotërinj!

Ne peputhje me kerkesen Tuaj, kam pergatitur raportin e vleresimit per pronen, “**Ndertese**” dhe Makineri e Paisje, e perbere nga nje Magazine+Zyra, objekt ndertimor 1-katesh me sipërfaqe totale ndertimi 450m<sup>2</sup>, te ofruar per vleresim sipas vlerave te Tregut te lire sot.

Kjo ndertese e perbere nga Magazina dhe Zyra te ndodhura brenda objektit ndertimor tip Magazine e ndertuar me konstruksione metalike, eshte e rregjistruar ne z.v.r.p.p. Kruje, me Nr. Pasurie 146/17-N, ne z. kadastrale 3183, vol.5 Faq. 215.

Kjo prone, sipas kartelave te Pasurise rezulton, ne pronesi shoqerise “Albania Airlines MAK” shpk. Ndertese sipas Statusit ligjor e ndodhur mbi Pasurine Nr. 146/13.

**me adrese : ”Rinas”**

Ne perputhje me dokumentet e paraqitura nga ana juaj dhe me informacionin verbal, me inspektimet dhe gjykimet e mia, kam pergatitur vleresimin e meposhtem per percaktimin e vleres sa me reale te prones, sipas vlerave te tregut sot.

Vleresuesit e pasurive te paluajtshme japin konsulence legale per prona dhe objekte te ndrysheme ndertimi, biznesi etj. Si vleresues profesionist jam i pajisur me license shteterore, edhe anetar i Shoqates se Vleresuesve te Pasurive te Paluajtshme (SVP), e cila na kontrollon ne drejtim te zbatimit te standardeve. Duke zbatuar standardet e profesionalizmit, ndershmerine dhe besueshmerine, ju do te merrni ne konsiderate punen e paraqitur. Vleresimi i paraqitur eshte bere ne perputhje me Manualin e Standardeve Europiane te Vleresimit.

**Vleresimi merr parasysh Vleren e Tregut dhe ka per baze vleren qe kane pronat qe vleresohen deri ne momentin e kryerjes se ketij vleresimi.**

Ne kete vleresim *do te jap opinionin tim mbi vleren reale te tregut, te interesit ligjor* mbi kete prone sot, duke supozuar se klienti eshte pronar i tyre dhe se titulli ligjor eshte i sakte i plote dhe mund te vertetohet.

Raporti i Vleresimit eshte konfidencial dhe vetem per perdorim dhe perfitim per qellimet specifike te cilave u referohet. Ai mund te perdoret nga keshilltare te tjere profesioniste per t’ndihmuar ne lidhje me sa me siper, por jo nga persona te tjere. Raporti, si i tere ose pjese te tij nuk mund te perfshihet ne asnje dokument te shkruar, qarkore apo deklarate dhe as nuk mund te publikohen pa miratimin tim me shkrim per formen dhe kontekstin ku mund te perdoret.

Raporti i Vleresimit shoqerohet me dokumentacionin teknik :

- Vendim per caktimin e Ekspertit, Gjykata e rrethit Gjyqesor Tirane.
- Kartela e Pasurise te Paluajtshme date 18.07.2016
- Planvendosje dhe foto te prones

Duke patur parasysh instruksionet tuaja ne lidhje me pronen dhe pasi kam bere inspektimet ne vend, investigimet dhe kerkimet e nevojshme mbi vlerat e tregut sot, kam kenaqesine t’ju raportoj si me poshte :

Jemi përpjekur të çmojme vlerën e kësaj prone në bazë të tregut real të saj, duke pasur parasysh qëllimin e ketij vlerësimi, që është njohja e vleres se prones per interesat e kreditoreve.

Ky raport do të përmbajë:

Një përshkrim të plotë dhe të detajuar të pronës, vendodhjen e saj dhe detaje të tjera që ndikojnë në vlerësim.

Vlerën e tregut të lirë, sipas kushteve të pronës, në datën 05.09.2016.

Raporti do të përmbajë keto supozime:

Gjate ndertimit dhe me vonë nuk janë përdorur materiale të demshme dhe të rrezikshme.

Prona është e lirë nga çdo barrë, e detyrim ligjor dhe pronësia është e pastër.

Rezultatet e kërkimeve në Hipoteke dhe në organet shtetërore nuk prekin pronën dhe vlerën e saj, si dhe përdorimi i tanishëm dhe i ardhshëm është i ligjshëm

**Mosinspektimi i vendeve të veçanta nuk sjell ndryshim në vlerësim.**

Ky raport vlerësimi bëhet konform licencës përkatëse si Vlerësues të Pasurive të Paluajtshme, të Shkallës Përkohëse të Kualifikimit si dhe Ing. Mekanik për makinerite.

Dokumentat për hartimin e raportit janë siguruar nga të interesuarit dhe porositësit e këtij raporti vlerësimi të cilat janë fotokopje.

### **Eksperti Vlerësues**

Ing. Gjergji Kotori Lic. Nr. 0106/1  
shkalla e Përkohëse

## **1. DATA E VLERESIMIT**

Prona u inspektua më datën 25.06.2016 dhe 05.09.2016 , raporti i vlerësimit u përgatit më datën 10.09.2016.

## **2. POROSITESI**

Ky raport është perpiluar për llogari të Gjykatës së rrethit Gjyqësor Tiranë, sipas kërkesës së Administratorit të Falimentit të Shoqërisë "Albania Airlines", shpk në falimentim për percaktimin e "Vlerës së tregut të lirë" së me reale të pronës objekt vlerësimi Ndertese 450m<sup>2</sup> dhe makineri e Pajisje që ndodhen Brenda objektit ndertimor, në Rrinas, dhe automjete.

## **3. ADRESA, PRONARI.**

**Prona :** Ndertese në Rrinas, pranë Aeroportit të Rrinasit, Tiranë

**Pronare:** Shoqëria "Albania Airlines" shpk, në falimentim.

## **4. BAZA E VLERESIMIT**

Opinionin tim për vlerën e kapitalit të pronës e kemi formuar në bazë të vlerave të shitjeve të pronave të ngjashme me pronën objekt vlerësimi të marra në zonën përreth, duke përdorur metodën e "Krahasimit të Drejtpërdrejtë" dhe metodën e kostos së zevendesimit të Amortizimit për materiale dhe pajisje të përdorura si metodat më të përdorura në vlerësimin e pasurive. Opinioni im mbi vlerat është bazuar në:

- Opinioni për vlerën e kapitalit të pronës Ndertese e kemi formuar në bazë të informacionit për vlerat e shitjeve të pronave në zonën përreth pronës objekt vlerësimi, duke përdorur Metodën e Krahasimit të Drejtpërdrejtë dhe, Metodën e Kostos.
- Opinioni për vlerën e kapitalit të Makinerive e Pajisjeve e kemi formuar në bazë të vlerave të shitjeve të pronave të ngjashme, të marra në tregun e brendshëm dhe atë të jashtëm, nëpërmjet internetit, duke përdorur metodën e Krahasimit të Drejtpërdrejtë si një nga metodat më të përdorura në vlerësimin e pasurive të lujtshme, si dhe Metodën e Kostos së zevendesimit të Amortizimit, sipas gjendjes teknike të tyre.

## **5. DOKUMENTAT NE KONSIDERATE**

Jam pajisur me një kopje të dokumenteve të pronës për pronën objekt vlerësimi. Në përpilimin e këtij raporti na janë vënë në dispozicion dhe kemi marrë në konsideratë këto dokumenta:

- Kartele e Pasurisë së Paluajtshme
- Inventari faktik
- Planimetria e objektit magazine + zyra.

Prona e mësipërme është në zotërim të Administratorit të Shoqërisë "Albania Airlines" shpk në faliment.

Ne lidhje me makinerite dhe Paisjet e zyres, jemi mbeshtetur ne gjendjen faktike te identifikuar ne vend ne prezence te perfaqesuesit te shoqerise "Albania Airlines" shpk. ne faliment, qe jane brenda objektit ndertimor me siperfaqe 450m<sup>2</sup>.

#### **- QELLIMI I VLERESIMIT**

Qellimi i ketij raporti eshte vleresimi i pasurise Ndertese me siperfaqe 450m<sup>2</sup>, 1 kat duke percaktuar Vleren reale te cmimit te shitjes per kete objekt dhe vleren e makinerive dhe paisje sipas inventarit fizik, e gjendjes faktike aktuale, te materialeve qe ndodhen brenda ketij objekti, ne kuadrin e percaktimit te vleres te aseteve te kesaj shoqerie.

- Qellimi i misionit eshte te percaktojme vleren e drejte te aseteve te pasurive te paluajtshme dhe atyre te luajtshme.

Gjate fazes se pergatitjes se ketij vleresimi ne:

- Kemi kryer inspektimin fizik te prones, vendodhjen aktuale te saj, eshte kryer inspektim vizual per te kualifikuar, gjendjen teknike aktuale te paisjeve.
- Kemi bere kryerjen e intervistave me personat teknik e pergjegjes te shoqerise.
- Kemi bere Genplanin dhe planimetrite e vendosjes se objektit, Rrugeve, e linjave te infrastruktures.
- Inventarizuam dhe regjistruam te gjitha materialet e paisjet qe jane gjendje, duke i pasqyruar ato ne vleresim.

Objekti, makinerite dhe paisjet se bashku me Paisje Zyre dhe Informatike si dhe automjete e materiale te tjera te "Albania Airlines" shpk, Rrinas u inspektuan, dhe u fotografuan gjate muajit qeshor-shtator 2016, ndersa raporti i vleresimit dorezohet brenda afatit te percaktuar ne kontrate.

#### **- METODAT E PERDORURA PER VLERESIM**

Ne vleresimin e te gjithë ketyre asetëve, per percaktimin e vleres se drejte ne kemi perdorur keto metoda per vleresim, qe jane ne perputhje me standartet europina te vleresimit, per te percaktuar vleren reale te tyre.

- **Metoden e krahasimit te drejtperdrejte dhe te ngjashme**
- **Metoden e kosos se amortizuar te zevendesimit.**
- **Metoda e Kosos**

Kemi vleresuar mirembajtjen, sherbimet dhe riparimet e kryera gjate aktivitetit, pra gjendjen faktike ne mometin e inspektimit fizik te tyre. Kemi marre parasysh faktoret qe ndikojne pozitivisht dhe negativisht per asetin, vleresimi eshte mbeshtetur ne nje analize me qellim kontrollin e tyre ne menyre korrekte ne daten e rivleresimit.

Meqenese shoqeria ka vite qe nuk funksjonon, kemi nje amortizim te madh te paisjeve dhe materialeve ku tregu eshte shume i kufizuar per keto tipe mjetesh, pasi dhe aktiviteti dhe performanca e shoqerise sherben si tregues negativ.

Grupi i eksperteve ne bashkepunim me stafin ka realizuar vleresimin e aseteve kryesore:

- I. **Vleresimi i Nderteseve**
- II. **Vleresimi i Makinerive dhe Paisje zyra**
- III. **Vleresim Automjete personi dhe sherbimi (autovetura)**

## **6. VENDODHJA E PRONES**

Prona objekt vleresimi, ndodhet ngjitur me territorin e rrethimit te Aeroportit te Rrinasit, ne nje distance prej rreth 100m larg zyrave te Administrates se Rinasit dhe kullës se vrojtimit te saj.

Ajo eshte perballe me magazinën e doganore (Kargo) dhe pikes se kontrollit te hyrjes se mjeteve e mallrave brenda territorit te aeroportit te Rrinasit, si dhe sheshit te parkimit per mjete ne sherbim te aeroportit, dhe personelit.

Zona ka pergjithesisht karakter sherbimi per aeroportin, ndertesat jane te tipit magazina dhe zyra 1-kat, buze rrugëve te brendshme te kalimi te zones, se kontrollit. Hyrja ne prone behet sipas rregullave te lejeve te hyrjes nga organet e kontrollit per cdo mjet. Lidhja e prones me rrugen kryesore te zones realizohet nepermjet rrugëve te brendshme te aeroportit.

Zona ne te cilen pozicionohet prona ka karakterin e biznesit, eshte ne sherbim te mjeteve fluturuese, aeropleneve dhe personelit qe sherbejne per realizimin e kushteve teknike. Këtij Raporti i janë bashkëngjitur në Lidhjen nr. 1 Vendodhja e prones, ne Lidhjen nr. 2 Planvendosja e prones, Lidhjen Nr. 3 fotografitë e prones

**Prona eshte i kufizuar:** Veriu - Hapsire e lire, shesh i rrethuar me rrjete teli.  
Jugu - Hapsire e lire, rruge kalimi e hyrjes ne objektin ndertimor  
Lidhja - Rruge kalimi, objekte sherbimi nje kateshe  
Perendimi - Shesh i lire Parkim Automjetesh

## **7.PERSHKRIMI I PRONES**

*Pershkrimi i prones sipas stausit ligjor.*

**Ndertese (Magazine +Zyra) me siperfaqe totale ndertimi 450m<sup>2</sup>.**

**Makineri – Paisje** te ndodhura brenda objektit ndertimor, **Ndertese 450m<sup>2</sup>**

**Pasuri Nr. 146/17-N, vol.5, faq. 215** **Ndertese me sip. totale 450m<sup>2</sup>, e Hipotekuar sipas karteles se Pasurise se Paluajtshme date 28.09.2015 te ZVRPP Kruje,** ne pronesi te "Albania Airlines MAK" shpk e ndodhur ne Rrinas

Kjo Ndertese per vleresim eshte e ndertuara mbi Pasurine truall nr. 146-13, zk. 3183, **Toke qe nuk eshte ne pronesi te shoqerise,** por vetem objekti ndertimor.

Makineri dhe Paisje qe jane pjese kryesore te funksjonimit te aktivitetit qe eshte i vendosur ne pjesen e brendshme te ndertesës (magazine + Zyra) me siperfaqe totale 450m<sup>2</sup>.

- *Gjendja aktuale e prones dhe perdorimi i tanishem i prones.*

Prona objekt vlerësimi është objekti **ndertimor** dhe, **Makineri Paisje** te vendosura ne brendesi te ndertesës, objekt i ndertuar rreth vitit 2003, i cili ka sherbyer per zyra dhe magazine per materiale e paisje (pjesë kembimi) per avjonet e shoqerise qe kryenin operacionet brenda territorit te aeroportit te Rinasit, ne perputhje me standartet teknike te miratuar nga autoritetet perkatese te aviacionit civil.

### **Ndertese 450m<sup>2</sup> me permasa 30m x 15m.**

Kjo prone është një ndertese qe nga punimet ndertimore perbehet nga një objekt i vetem tip Hangari i ndertuar me konstruksione metalike, me dy dyer kryesore ne ballin e saj per hyrjen e punonjesve dhe mjeteve.

Eshte objekt i ndertuara para 15 vjeteve, me konstruksion metalik ku brenda ketij objekti kemi te ndertuar me materiale kartonxhesi disa zyra, dhe dy magazina qe jane te mbuluara me tavan te lehtesuar dhe te kompletuara me rafte dhe tavolina pune.

Elemntet kryesore jane Profilet metalike te standartizuara si kollona, trare, tiranda, kapriata, te cilat lidhen (montohen) ne nyje perkatese me bollona + saldim duke formuar një konstruksion metalik te mbuluar me elemnete, llamarine e valezuar si nga siper eshtu edhe ne pjeset anesore. Objekti është i paisur dhe me dy panele elektik një box te jashtem dhe një panel i leshuesve dhe sigureseve brenda ndertesës, duke bere te mundur funksjonimin normal te saj, me rrjetin e energjise.

Brenda ketij objekti ne magazina kemi dhe shume pjesë kembimi per tipet e avjonave qe ka shoqeria, pjesë keto qe jane futur ne vleresimin e avjonave, pjesë te domosdoshme per funksjonimin e tyre. Keto jane pjesë vetem per keto tipe avjonesh dhe si e tille keto materiale jane pjesë e tyre ne vleresim.

Elemente kryesore qe perbejne kete ndertese jane:

#### **1. Magazina e materialeve te Reja me permasa 10m x 5.7m = 57m<sup>2</sup>**

Eshte një magazine e ndertuar me te kater faqet dhe tavanin me material panele sandwic dhe trare metalike, qe sherbejne per ndarjen nga ambjentet e tjere te ndertesës, është me lartesi 4.6metra, e cila ka një dëre duralumini brenda te ciles kemi keto materiale dhe paisje:

- Rafte matalik me permasa 3x2.6me 5 ndarje me profil "L"=60m/m **7 cope**
- Rafte matalik me permasa 3x0.5me 6 ndarje me profil "L"=25m/m **2 cope**
- Tavoline me suprine melamine me permasa 1.4m x 1m **1 cope**
- Kompjuter komplet monitori, njesia dhe printeri **2 cope**
- Suport ngritje motori hidraulik i markes ENERPAC, **1 cope**

#### **2. Zyra e Magazinjerit me permasa 3m x 2m = 6m<sup>2</sup>**

Eshte një magazine e ndertuar me te kater faqet dhe tavanin me material kartonxhesi dhe trare druri qe sherbejne per ndarjen nga ambjentet e tjere te ndertesës, me lartesi 3metra, e cila ka një dëre duralumini brenda te ciles kemi keto materiale dhe paisje:



- Raftë metalik me permasa 2m x 1.5m me kater ndarje me profil "L"=30m/m **2 cope**
- Dollap me kanatë xhami me permasa 2m x 1m me malamin **1 cope**
- Tavoline me suprinë melamine me permasa 1.2m x 0.75m **1 cope**
- Komodine melamine me tre sirtare me lartësi 0.6m **1 cope**
- Dollap me dy kanatë malamine me permasa 1.5m x 1m **2 cope**

### **3. Magazina e materialeve të përdorura me permasa 5m x 4.4m = 22m<sup>2</sup>**

Është një magazinë e kufizuar me të kater faqet dhe tavanin me material panele sandwic dhe trarë metalike, që shërbejnë për ndarjen nga ambientet e tjera të ndërtesës, me lartësi 4.6metra, e cila ka një derë duralumini brenda të ciles kemi këto materiale dhe paisje:

- Raftë metalik me permasa 2.2m x 1.8m me kater ndarje me profil "L"=50m/m **1 cope**
- Raftë metalik me permasa 4.5m x 2.2m me kater ndarje me profil "L"=30m/m **1 cope**
- Dollap metalik me permasa 3.2m x 1.2m me kater ndarje me kanatë llamarinë **2 cope**
- Pjesë kembimi të përdorura me sasi rreth **700Kg**

### **4. Zyra e Supervizionit me permasa 5m x 2.4m = 12m<sup>2</sup>**

Është një magazinë e kufizuar me të kater faqet dhe tavanin me material kartonxhesi dhe trarë druri dhe profile metalik, që shërbejnë për ndarjen nga ambientet e tjera të ndërtesës, me lartësi 3metra, e cila ka një derë duralumini brenda të ciles kemi këto materiale dhe paisje:

- Raftë metalik me permasa 2m x 2m me kater ndarje me profil "L"=35m/m **4 cope**
- Karrike me mbështetëse dhe krahe **1 cope**
- Tavoline melamine me permasa 0.8m x 0.6m me një sirtar **1 cope**

### **5. Zyra e Teknikës me permasa 5m x 2.4m = 12m<sup>2</sup>**

Është një magazinë e kufizuar me të kater faqet dhe tavanin me material kartonxhesi dhe trarë druri që shërbejnë për ndarjen nga ambientet e tjera të ndërtesës, me lartësi 3metra, e cila ka një derë duralumini brenda të ciles kemi këto materiale dhe paisje:

- Raftë metalik me permasa 3m x 2m me kater ndarje me profil "L"=35m/m **1 cope**
- Karrike rrotulluese me mbështetëse të veshur me imitacion lëkure e krahe **1 cope**
- Tavoline melamine me permasa 1.5m x 0.6m **1 cope**
- Dollap melamine me permasa 2.2m x 1.2m me dy kanatë **5 cope**

### **6. Zyra e Mirembajtjes me permasa 5m x 2.4m = 12m<sup>2</sup>**

Është një magazinë e kufizuar me të kater faqet dhe tavanin me material kartonxhesi dhe trarë druri dhe profile metalik, që shërbejnë për ndarjen nga ambientet e tjera të ndërtesës, me lartësi 3metra, e cila ka një derë duralumini brenda të ciles kemi këto materiale dhe paisje:

- Raftë metalik (dollar) me permasa 1m x 0.8m **1 cope**
- Karrike rrotulluese me mbështetëse të veshur me imitacion lëkure e krahe **2 cope**
- Tavoline melamine me permasa 1.2m x 1m **2 cope**
- Raftë druri mbajtëse dokumentash me permasa 2.2m x 2.4m me pesë raftë **2 cope**

- Karrike me kembe metalike dhe ndenjese rrobe **3 cope**

### **7. Zyra e Managerit me permasa 5m x 2.4m = 12m<sup>2</sup>**

Eshte nje magazine e kufizuar me te kater faqet dhe tavanin me material kartonxhesi dhe trare druri, e profile metalik, qe sherbejne per ndarjen nga ambjentet e tjere te nderteses, me lartesi 3metra, e cila ka nje dere duralumini brenda te ciles kemi keto materiale dhe paisje:

- Raftet matalik (dollap) me permasa 1m x 0.8m **1 cope**
- Karrike rrotulluese me mbeshtetese te veshur me imitacion lekure e krahe **2 cope**
- Tavoline melamine me permasa 1.2m x 1m **2 cope**
- Raftet druri mbajtese dokumentash me permasa 2.2m x 2.4m me pese raftet **2 cope**
- Karrike me kembe metalike dhe ndenjese rrobe **3 cope**

### **8. Salla e Pushimit me permasa 5.5m x 3.2m = 17.6m<sup>2</sup>**

Eshte nje magazine e kufizuar me te kater faqet dhe tavanin me material kartonxhesi dhe trare druri e profile metalik, qe sherbejne per ndarjen nga ambjentet e tjere te nderteses, me lartesi 3metra, e cila ka nje dere druri brenda te ciles kemi keto materiale dhe paisje:

- Karrike rrotulluese me mbeshtetese te veshur me imitacion lekure e krahe **1 cope**
- Tavoline melamine me permasa 1.4m x 1m **3 cope**
- Divan tre vendesh 3m x 1.1m me hapje **2 cope**
- Karrike rrotulluese me mbeshtetese te veshur me imitacion lekure e krahe **1 cope**
- Karrike me kembe metalike dhe ndenjese rrobe **2cope**
- Kalorifer me vaj me nente elemente **1 cope**

### **9. Zyra e Mirembajtjes me permasa 2.5m x 3.2m = 8m<sup>2</sup>**

Eshte nje magazine e kufizuar me te kater faqet dhe tavanin me material kartonxhesi dhe trare druri qe sherbejne per ndarjen nga ambjentet e tjere te nderteses, me lartesi 3metra, e cila ka nje dere Druri brenda te ciles kemi keto materiale dhe paisje:

- Raftet matalik (dollap) me permasa 1m x 0.8m **1 cope**
- Karrike rrotulluese me mbeshtetese te veshur, imitacion lekure e krahe **1 cope**
- Tavoline melamine me permasa 1.2m x 1m **1 cope**
- Raftet druri mbajtese dokumentash me permasa 2.2x2.4m me pese raftet **1 cope**
- Karrike me kembe metalike dhe ndenjese rrobe **2 cope**

### **10. Tualet me permasa 5m x 1.6m = 9m<sup>2</sup>**

Kemi nje tualet i kompletuar i veshur dhe shtruar me pllaka qeramike dhe paisje hidrosanitare me dy ndarje per tualet e dush.

Te gjithet keto ambjente zyra qe pershkruam me siper ndodhen dhe komunikojne nga nje dere e jashteme metalike ku nepermjet hapsirave korridoreve te kalimit komunikon me te gjithet keto ambjente te cilat jane te suvatuara te lyera me instalimet elektrike, shtresat me pllaka

qeramike dhe te kompletuar me dy kondicionere. Keto zyra ne korridorin e perbashket eshte edhe tualeti i kompletuar me pllake dush, bolier, wc dhe vend per mbajtjen e materialeve sanitare.

Kurse dy magazinat jane me parete anesore ndarje me llamarine e panel sandwic dhe shtresa me pllaka, ku jane vendosur rafte me materiale per pjese kembimi per avjone.

**Pjesa tjeter qe ka hyrje tjeter, dere e pavaruar nga pjesa qe kemi pershkruar deri tani, brenda ketij objekti me sipërfaqe 450m<sup>2</sup> kemi keto ambiente dhe materiale.**

### **1. Magazine e Rikuperos me permasa 17m x 4m = 68m<sup>2</sup>**

Kjo magazine eshte e hapur komunikon direkt me deren e jashteme metalike ku ne njeren ane kemi te ndertuara pese zyra te tjera me material mure ndarese dhe tavan kartonxhes, te lyera dhe te suvatuara me shtresa pllake dhe instalime elektrike, kurse ne hapsiren e lire kemi sheshin e magazines ne lartesine e objektit prej 6.2metra, ku jane vendosur ne dysheme, materialet ku nje pjesa jane materiale te aeroportit. Kemi keto makineri-paisje ne administrim te shoqerise:

- Motorra per avjone te dala jashte perdorimit **2 cope**
- Paisje ngritese avjoni ne gjendje pune **3 cope**
- Tiranda terheqje avioni ne gjendje pune **3 cope**
- Karrike te dala jashte perdorimit **10 cope**
- Skanera per kontrollin e bagazheve **2 cope**
- Transportier me shirit gome me gjatesi 3metra **2 cope**
- Shkalle metalike te levizeshme per hipjen ne avjon **2 cope**
- Tavolina metalike me permasa 2m x 1m **2 cope**
- Varese rrobash metalike (prift) **8 cope**

### **2. Magazine Jashte Perdorimi me permasa 15m x 5m = 75m<sup>2</sup>**

Kjo magazine eshte e hapur komunikon direkt me deren e jashteme metalike ne vazhdim te magazines se Rikuperos me nje ndarje dere llamarine futesh ne kete ambient i cili eshte i hapur dhe ne lartesine e gjithe objektit prej 6.2metra.

Brenda ketij rrehi ndodhen materiale te dala jashte perdorimit si sedile, tavolina, pjese kembimi te dala jashte perdorimit te gjitha keto materiale jane per scrap me sasi rreth 250 kg materiale hekuri (mbetje nga demolimi i tyre)

- Materiale hekuri sedile, tavolina, pjese kembimi 300Kg
- Rafte metalik, ulluqe, kasa me material hekuri te xinguar 200Kg.
- Rafte metalik me profile "L" me gjatesi 15m x 2.2m x 0.6
- Tavolina pune metalike te levizshme me rrota **2 cope**
- Konstrukione metalike, rafte profile sasia rreth **200Kg.**
- 

### **3. Zyrrat e punonjesve me permasa 4m x 2.4m gjithsejt 5 zyra = 48m<sup>2</sup>**

Jane zyra te ndertuar me te kater faqet dhe tavanin me material kartonxhesi dhe trare druri qe sherbejne per ndarjen nga ambjentet e tjere te ndertesës, me lartesi 3metra, te cilat kane secila dere druri (veshje melamine) me hyrje dalje ne korridorin e kalimit lidhen me deren kryesore te jashtme nr.2.

Brenda ketyre zyrave te gjithë keto ambjente te cilat jane te suvatuara te lyera me instalimet elektrike, shtresat me pllaka qeramike dhe te kompletuar, por nuk kane paisje zyre, jane vetem disa materiale metalike qe i kemi pershkruar me siper.

- *Pamje e Jashteme.*

Prona Ndertesa eshte ne buze te rruges se kalimit ne hyrje te mjeteve te territorit te Aeroportit te Rinasit ne anen veriore, eshte kufizuar me rruge dhe sheshe kalimi qe i perkasin zones se sigurise te aeroportit, ne afersi te magazines doganore (Karrgo)

I gjithi ky investim ka perfunduar se ndertuari dhe eshte vene ne funksjonim qe ne vitin 2003, i kompletuar me te gjitha instalimet per funksjonimin e Zyrave dhe Magazines si lidhja me rrjetin e infrastruktures kanalizime, energji, uje etj. qe jane pjese e projektit te ndertimit te kesaj ndertese e kufizuar nga jashte vetem me materiale llamarine te valezuar, ku ndricimin e mer nga dritaret jo te hapshme te vendosura ne gjithë gjatesine nga te kater anet. Hyrja per ne prone behet nga ana jugore e ballit te pronës, nepermjet rruges te kalimit, qe kalon nga pika e kontrollit te aeroportit, me rrugen kryesore para aeroportit ne rrethotullimin e bustit te “Nene Terezes”

- *Pamje e Brendeshme*

Objekti eshte i perfunduar nga punimet ndertimore dhe ka qene ne aktivitet deri ne vitin 2012, ka rreth 5vjet qe qendron i mbyllur braktisur, ku duken edhe demtime te brendshme sidomos tavanëve dhe paisjeve te zyreave. Objekti eshte konstruksioni metalik me nje pjese llamarine e xinguar te pa ndryshkura, si materiale ndertimore te kohës.

Brenda eshte nje hapsire e vetme me kallona profil “T” me konstruksion metalik, mbuluar me Lllamarine te lyer, dhe ne faqe anesore., pa tavan. Duhet te theksoj se brenda ketij Hangari kemi te ndertuara zyrat ne lartesine 3metra dhe dy magazina me lartesi 4.5metra, pjesa tjetër eshte hapsira e objektit me lartesi 6.2metra, permasat jane dhene dhe ne skicen perkatese.

- *Informacion per mosperputhje te gjendjes faktike te pronës e krahasuar me dokumentet ligjore:*

Gjate inspektimit nuk jane konstatuar mosperputhje midis te dhenave te dokumentave ligjore dhe gjendjes faktike te pronës persa i perket siperfaqës te pronës. Sipas matjeve ne teren rezulton se siperfaqja e pergjithshme e Nderteses **eshte 450m2, mbi Pasurine nr.146/17-N, zk. 3183**, ne pronesi te Albanian Airlines shpk. ne Rrinas.

- *Infrastruktura:*

Nga nje inspektim siperfaqësor themi se prona eshte e pajisur me infrastrukturen e nevojshme.

Prona gjendet ne nje zone sherbimi te aeroportit jane bere investime te lidhjes se pronës me rrugen kryesore te zones qe eshte ne funksjon. Prona objekt inspektimi e vleresimi ka burime energjie dhe uji, me rrjetin kryesor te shperndarjes, e kanalizimet.

Kanalizimet e ujrave te zeza jane te brendeshme dhe lidhen me grope septike.

Theksojme se ne prone eshte ne nivele te mira edhe infrastruktura e komunikimit te tipeve te ndryshme te telefonise

**- *Informacione mbi ndotjen reale ose te mundshme:***

Nuk jam ne dijeni te pranise se materialeve ndotese apo te rrezikshme ne pronen ne fjale dhe as ne zonen perreth. Nese ne vijim percaktohet se ne pronen e vleresuar, ose ne zonen perreth ekziston ndotje, kjo mund te zvogeloje vleren e raportuar.

**- *Aksesi, mbi mundesine e hyrjes dhe daljes ne prone***

Aksesi i hyrje daljes ku ndodhet prona, realizohet vetem nepermjet rruges dytesore te kalimit me gjatesi 100m e shtruar me asfalt por qe duhet leje hyrje nga organet e aeroportit dhe kontrolli i siguritise.

Hyrja per mjetet eshte e kufizuar nepermjet kontrollit te pikes se hyrjes ne aeroport.

**- *Informacion rreth kufizimeve te mundeshme ne perdorimin e pronës ose pjeseve te caktuara te saj.***

Sipas dokumentit te pronësise te vene ne dispozicion, informacioneve te mbledhura e kqyrjes ne vend na rezulton se ka kufizime ne perdorimin e pronës ose ne pjese te vecanta te saj:

